

NEWSLETTER

Publikim i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Prill 2018



EVENTE

- IDE NOVATIVE PER SIGURIMET NGA STUDENTET E UET
- KLINIKA MJEKESORE SIGAL UNIQA SHERBIM FALAS PER BANORET E BELSHIT

Marketing&Pergjegjesi sociale

- BALLO VJENEZE NE SHQIPERI
- SHITJE E KOMBINUAR: SIGURIMI TPL+SIGURIMI I APARTAMENTIT

TREGU I SIGURIMEVE

- TE DHENAT NGA AMF PER PERIUDHEN JANAR-MARS 2018, SIGAL UNIQA UDHEHEQ TREGUN

EVENTE



IDE NOVATIVE PER SIGURIMET NGA STUDENTET E UET

Në muajin mars SIGAL UNIQA në bashkëpunim me Universitetin European të Tiranës shpalli konkursin për idenë novatore më të mirë për tregun e sigurimeve në Shqipëri. Kjo ishte faza e parë, ku u prezantua konkursi në një dialog të hapur së bashku me studentët dhe pedagogët e UET.

Tanimë konkursi është futur në fazën e dytë. Studentët e UET vizituan zyrat e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe zhvilluan një bashkëbisedim me Drejtorin e Përgjithshëm të SIGAL UNIQA, z. Ponari, për të folur mbi idetë e tyre dhe sesi ata e mendonin të ardhmen e tregut të sigurimeve në vendin tonë.

Studentët i dorëzuan idetë e tyre mbi risinë që ata mendojnë të zhvillojnë në tregun e sigurimeve, dhe në fazën e tretë që përkon në fund të muajit maj do të shpallen edhe fituesit. Tri idetë më të mira do të vlerësohen me çmime.

KLINIKA MJEKESORE SIGAL UNIQA SHERBIM FALAS PER BANORET E BELSHIT

Rreth 250 persona morën ekzaminime shëndetësore falas përgjatë 3 ditëve të qëndrimit të Klinikës Lëvizëse SIGAL në Belsh.

Ekipi i mjekëve, i cili përbëhet nga mjekë patolog, reumatolog, kardiolog dhe imazherist u shërbeu banorëve të zonës për 3 ditë me radhë me profesionalizëm maksimal.

Vetë Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, z. Ponari ndoqi nga afër punën e bërë nga klinika mjekësore në Belsh dhe bisedoi me banorët e zonës, për të dëgjuar problematikat që ata kanë dhe për ti inkurajuar ata që të kryejnë ekzaminimet mjekësore, sepse është më mirë të parandalosh një sëmundje ses ta kurosh atë.

KLINIKA MJEKESORE NE VUNO


Klinika Mjekësore SIGAL UNIQA udhëtoi në një tjetër skaj të Shqipërisë, në fshatin Vuno të Himarës, një prej perlave të rivierës shqiptare.

Për 3 ditë me radhë klinika qëndori e hapur 24 orë, për t'ju shërbyer banorëve të zonës, por edhe për turistëve shqiptarë dhe të huaj që kishin ardhur atje për festivalin South Outdoor Festival.

Banorët e zonës shprehën mirënjohje për shërbimin e ofruar dhe për mundësinë që SIGAL UNIQA u dha nëpërmjet klinikës për tu ekzaminuar falas. Për shumë turistë, klinika ishte një surprizë dhe risi, sepse një shërbim të tillë nuk e kishin parë më përpara.

Marketing & Përgjegjësi Sociale

BALLO VJENEZE NE SHQIPERI



Në kuadër të vitit kulturor Shqipëri-Austri SIGAL UNIQA ka mbështetur një sërë projektesh dhe evente social-kulturore si në Shqipëri ashtu edhe në Austri.

Balloja Vjeneze, e cila u zhvillua në Pallatin e Kongreseve në Tiranë më datë 21 prill, ishte event i radhës i mbështetur nga SIGAL UNIQA. Një pjesë e kulturës austriake u bë pjesë edhe e kulturës shqiptare, përmes kësaj balloje të veçantë.

SHITJE E KOMBINUAR: SIGURIMI TPL+SIGURIMI I APARTAMENTIT

Përgjatë muajit prill SIGAL UNIQA ka dalë në treg me një ofertë të re. Për të gjithë individët që blejnë siguracionin e makinës me prim të plotë, përfitojnë falas sigurimin e apartamentit.

Kjo shitje e kombinuar vlen si për blerjet online ashtu edhe për blerjet në zyrat e SIGAL UNIQA.

Oferta është e vlefshme vetëm për sigurimin e apartamentit, jo për shtëpitë private apo vilat. Këto lloje banesash duhet të sigurohen veçmas dhe jo si pjesë e paketës TPL+sigurim apartamenti.

TREGU I SIGURIMEVE

Të dhënat nga AMF, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e para në tregun e sigurimeve, me rreth 30% të tregut.

Nga të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për muajin janar-mars 2018, SIGAL vazhdon të udhëheqë tregun duke zotëruar përkatësisht:

- 60.04%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Jetës;
- 27.65%** të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimin e Jo-Jetës
- 21.98%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike;
- 51.10%** të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Pasurisë;
- 32.63%** të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për shoqëritë Jo-Jetë.

Sipas AMF, tregu rezulton me një rritje prej 2.53% më shumë se në janar-mars 2017. Primet bruto kapën shifrën mbi 3,552 milionë lekë. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 261,173 me një rritje prej 5.54% krahasuar me janar-mars 2017.

Për më shumë informacion kontaktoni: internal@sigal.com.al

©SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. 2018